

UKD sh.a.
Ujesjelles Kanalizime Durrës

Pasqyrat Financiare te Auditura
Per periudhen kontabel e mbylluar me 31 Dhjetor 2013
se bashku me raportin e audituesit

Përmbledhje e Lendes

1.	TE PËRGJITHSHME	12
2.	BAZAT E PERGATITJES.....	14
3.	POLITIKAT KONTABEL	14
3.1	RAPORTIMI I SEGMEVE TE BIZNESIT.....	14
3.2	KONVERTIMI I TRANSAKSIONEVE NË MONEDHË TË HUAJ	15
3.3	NJOHJA E TE ARDHRAVE.....	15
3.4	MAKINERI DHE PAJISJE PUNE TE UJESJELLESIT DHE KANALIZIMET, MAKINERI DHE PAJISJE PUNE TE TJERA DHE AKTIVE JOMATERIALE.....	16
3.5	INVENTARET.....	18
3.6	TATIMI I SHTYRE.....	18
3.7	TATIMI AKTUAL.....	18
3.8	PERFITIMET E PUNONJESVE	18
3.9	INSTRUMENTAT FINANCIAR DHE C'RREGJISTRIMI I TYRE	18
3.9.1	AKTIVET FINANCIARE	18
3.9.2	DETYRIMET FINANCIARE.....	19
3.9.3	ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE FINANCIARE	19
3.9.4	ÇRREGJISTRIMI I INSTRUMENTAVE FINANCIARE	20
3.10	QERATE	20
3.11	MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTËT E MJETEVE MONETARE.....	20
4.	MENAXHIMI I RISKUT.....	21
4.1	MANAXHIMI RISKUT FINANCIAR	21
4.2	RISKU I KREDITIMIT	24
4.3	RISKU I LIKUIDITETIT	26
4.5	VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË.....	28
5.	ÇMUARJE DHE GJYKIME KRITIKE TË KONTABILITETIT	29
5.1	MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE.....	29
5.2	NJOHJA E TE ARDHURAVE.....	29
5.3	RENIA NE VLERE E AKTIVEVE	30
5.4	RENIA NE VLERE E LLOGARIVE TE ARKËTUESHME.....	31
5.5	FSHIRJA E LLOGARIVE TE ARKËTUESHME SI REZULTAT I AMINISTISE	33
5.6	TATIMI MBI TË ARDHURAT	34
6.	KRAHASUESHMËRIA.....	34
7.	RAPORTIMI SEGMENTAR	35
8.	TE ARDHRAT NGA SHITJA	36
8.2	ARDHURAT NGA AKTIVITETI I PARREGULLUAR	37
8.3	ARDHURA NGA KAMATVONESAT DHE TJERA.....	37
9.	SHPENZIME TE NXJERRJES DHE PERPUNIMIT TE UJIT TE PIJSHEM DHE TE NDOTUR	38
10.	SHPENZIME TE PËRGJITHSHME SHFRYTEZIMIT DHE MIREMBAJTJES.....	38

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2013 se bashku me shenimet shoqeruese

Shumat ne mije Leke (permdryshe shkruhet)

11.	SHPENZIMET PERGJITHSHME TE AKTIVITETIT TE SHITJES	38
12.	SHPENZIMET TE PERGJITHSHME ADMINISTRATIVE.....	39
13.	SHPENZIMET PER PERSONELIN.....	39
14.	SHPENZIME DHE TE ARDHURA FINANCIARE.....	40
15.	SHPENZIME TATIM FITIMI	41
15.1	TATIM FITIMI AKTUAL KONTABEL	41
15.2	TATIM FITIMI I SHTYRE.....	41
16.	LLOGARITE DHE VENDOSJET ME BANKAT	41
17.	LLOGARITE E ARKETUESHME.....	41
17.1	LLOGARITE E ARKETUESHME TE TJERA	42
18	INVENTARET.....	42
19	MAKINERI, PAJISJE PUNE DHE RRJETE SPECIFIKE	43
20	LLOGARITE E PAGUESHME	45
21	DETYRIME NDAJ SHTETIT DHE PERSONELIT	45
22	HUAJA NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE	46
23	GRANTE DHE NDIHMA QEVERITARE.....	47
24	LLOGARITE E KAPITALIT.....	47
25	TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA	49
26	DETYRIME DHE ANGAZHIME JASHTJE BILANCIT	49
27	CESHTJE GJYQESORE.....	49
28	NGJARJE PAS DATËS SE PËRPILIMIT TE RAPORTIMIT FINANCIAR.....	50

Raporti i Audituesit te Pavarur

Ne Vemendje te Mbledhjes se Pergjithshme te Aksionereve:

Ujesjelles Kanalizime Durres ShA.

Lagja 17, Rruga "Dalip Peza" Durres

Raportim ne lidhje me Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te Ujesjelles Kanalizime Durres ShA ("UKD"), te cilat perfshijne Pozicionin Financiar per vitin qe mbyllet me date 31 Dhjetor 2013 dhe pasqyrat perkatese te Ardhurave Gjitheperfshirese, Ndryshimit te Kapitaleve te veta dhe te Flukseve te mjeteve monetare per kete vit ushtrimor si dhe nje permbledhje te politikave me kryesore te kontabilitetit dhe shenimet shpjeguese.


Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi mban pergjegjesi per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Standartet Kombetare te Raportimit Financiar. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pregatitjen e pasqyrave financiare qe te mos permbajne anomali dhe gabime materiale, duke zgjedhur dhe aplikuar politika te pershtatshme te kontabilitetit; dhe duke bere vleresime te arsyeshme kontabel ne varesi te situates.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia e jone eshte, qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale.

Ky auditim perfshin kryerjen e procedurave per te marre evidencat e auditimit rreth shifrave dhe paraqitjeve ne pasqyrat financiare. Keto procedura te cilat zgjidhen ne varesi te gjykimit te audituesit, perfshijne vleresimin e rrezikut te gabimeve materiale te pasqyrave financiare, qe mund te kene ndodhur per shkak te mashtrimit ose te gabimeve. Per realizimin e vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare te shoqerise me qellim te hartoje procedura te auditimit te pershtatshme sipas situates, por jo me qellimin e shprehjes se nje opinioni ne lidhje me efektivitetin e kontrollit te brendshem te shoqerise. Ky auditimin perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdoruara dhe arsyeshmerine e vleresimeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.



Ne besojme qe evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per tu perdorur si baze ne dhenien e opinionit tone te audituesit.

Bazat e Opinioni te Kualifikuar (me Rezerva)

1. Llogarite e Arketueshme –Kliente. Te Ardhurat nga Furnizimi me Uje dhe Largim e Trajtim Ujrash te Ndotur.

1.1 Njohja Fillestare –Klientet

Shoqeria ka nje numer prej rreth 70 mije klientesh ne fund te periudhes 2013, te cilet evidentohen ne nje sistem faturimi dhe arketimi. Te dhenat e klienteve nuk permbajne te dhenat identifikuese te cilat jane te domosdoshme per plotesimin e kushtit te njohjes se te drejtes. Ne nuk mund te vleresojme masen e gabimit material pasi nuk ka informacion ne lidhje me: kontratat inekzistente, kontratat e dubluara etj.

1.2 Njohja e te Ardhurave – Matja me Besueshmeri

Shoqeria aplikon perlllogaritjen e konsumeve aforfe per rreth 20% te klienteve (13,182 kliente). Kjo perlllogaritje aplikohet ne masen rreth 4,5 m3 per fryme. Kjo llogaritje nuk merr parasysh konsumet reale te konsumatoreve duke mos pasur nje siguri ne lidhje me 40% te te ardhurave qe rrjedhin nga keta konsumatore ose 208 Milion leke kundrejt 521 Milion leke per furnizimin me uje te pijshem. Ky efekt shtrihet dhe ne llogarite e Klienteve dhe gjendjet debitore te tyre.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

2.1 Njohja Fillestare

Shoqeria njeh aktivet duke evidentuar koston e blerjes perkatesisht bazuar ne faturat e furnizimit apo koston e materialeve per ndertimet ne ekonomi. Megjithate per periudhat pararendese (bilanci i celjes 01 Janar 2013) ajo nuk ka nje evidence kontabel te rregjistrat te aktiveve dhe menyren e perfitimit te tyre. Shuma e ketyre aktiveve te pasaktesuara eshte 4.1 miliard leke (rrjete Ujesjelles dhe Kanalizime). Ne nuk mundem te vleresojme masen e aktiveve qe mund te mungojne ne rregjistrat e shoqerise dhe si te tille dhe efektin ne vleresimin e perlllogaritjes se amortizimit.

2.2 Rivleresimi i Aktiveve

Shoqeria paraqet Aktivet me Vleren e Drejte te tyre ne kontabilitet. Si rrjedhoje ajo ka kontraktuar vleresues te aktiveve gjate periudhes 2011 dhe 2013, perkatesisht per Terrenet dhe Ndertesarat ne Vitin 2011 se bashku me rrjetin e Kanalizimit dhe ne Vitin 2013 per Rrjetet e Ujesjelles. Bazuar ne rezultatin e ketyre rivleresimeve shoqeria ka paraqitur ne bilancin e celjes 1 Janar 2013 perkatesisht:



Diferenca Rivleresimi qe rrjedhin nga Angazhimi i Viti 2011

Terrenet dhe Ndertesat-	Shtese Vlere 450 Milion leke
Rrjete Kanalizime-	Pakesim Vlere Kosto Historike 1,4 Miliard leke dhe Amortizim i Akumuluar 1,2 Miliard leke per nje rezultat neto qe eshte perfshire ne rezultatin e viti 2012 prej 126 Milion leke.

Diferenca Rivleresimi qe rrjedhin nga Angazhimi i Viti 2013

Rrjete Ujesjelles-	Shtese Vlere Ujesjelles 15,6 Miliard leke.
--------------------	--

Bazuar ne SKK 5 , Metoda e Rivleresimit, ne te cilen theksohet qe rivleresimi behet per teresine e grupit te aktiveve, Shoqeria ka sistemuar bilancin e celjes te viti 2013 duke risistemuar vleren e rrjeteve kanalizime dhe korrigjuar efektet e rivleresimit te vitit 2013 per rivleresimin e rrjetit ujesjelles.

Si pasoje Aktivitet e Shoqerise pervec Zerit Toka, Terrene dhe Ndertesa, jane te paraqitura me kosto historike korrigjuar me amortizimin e akumuluar.

Ne mendojme se vlera neto kontabel e aktiveve ne masen 2.5 Miliard leke nuk paraqet vleren e drejte te aktiveve te shoqerise si rrjedhoje ne vijim dhe te pikes 2.1 sa me lart nevojitet, identifikimi dhe rivleresimi i teresise se aktiveve te shoqerise sipas grupeve perkatese: Vepra infrastrukture , Makineri dhe Pajisje Pune , Mjete Transporti etj aktive ne perdorim.

2.3 Vleresimi i metejshe - llogaritja dhe rregjistrimi i amortizimit

Sa me siper shoqerohet dhe me mungesen e detajimit te infrastruktures ne Rrjete Civile dhe Komponente te rrjeteve per te cilet dhe jetegjatesia fillestare eshte e ndryshme. Keto shoqerohen me efekte ne amortizimin e aktiveve infrastrukture.

3. Detyrimet per kontratat e nenhuase dhe Granteve

3.1 Njohja Fillestare

Mungesa e evidences se aktiveve te shoqerise sa shpjeguar me siper ben te mundur dhe mossaktesine ne paraqitjen e shumave te detyrimeve perkatese per kontratat e nenhuase. Shoqeria ka Njohur 2,3 Miliard leke kontrata nenhuaje qe rrjedhin nga Projekte te Financuar nga Organizata e Vendeve Exportuese te Naftes (OPEC) USD 2 milion, Banka Europiane e Investimeve (BEI) ne vleren Euro 6,6 Milion dhe Agjensia Nderkombetare e Financimit (IDA) per vleren SDR 2,6 Milion.

Gjendjet ne Bilanc perbehen nga Kestet e Pagueshme per Vleren 1,7 Miliard leke te paraqitura ne Detyrimet Afatgjata si dhe Kestet e Papaguara se bashku me Interesat ndaj Ministrise se Financave 652 Milion leke te paraqitura ne zerin Detyrime Afashkurtra.

Mungesa e inventarizimit te aktiveve dhe njohjes se tyre mund te coje dhe ne mungesa te kredive ne paraqitjen e tyre ose ne llogaritje e granteve. Ne nuk mundem te vleresojme masen e detyrimeve dhe granteve qe mund te mungojne ne pozicionin financiar te shoqerise dhe si te tille dhe masen e shpenzimeve te interesave dhe amortizimin e granteve.




Opinion

Sipas opinionit tone, si pasoje e zerave te perfshire ne bazen e opinionit te kualifikuar (me rezerva) per sa me siper permendur, pasqyrat financiare, te marra ne teresi dhe ne te gjithe aspektet materiale, japin nje pamje te vertete dhe te singerte te situates financiare Ujesjelles Kanalizime sha me 31 Dhjetor 2013, te rezultateve te veprimtarive te saj, te fluksit te mjeteve monetare per periudhen kontabel te mbyllur ne kete date, ne pajtim me Ligjin Nr 9228 date 29.04.2004, i ndryshuar dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Ekspertet Kontabël te Regjistruar

Dhimitër KUSHI

Luan GOSNISHTI



Durres, me 20.06.2014



Adresa :
Lagja 4 , Rruga "Egnatia"
Mbrapa Qendres Tregetare
"Blu Star" Durres

Adresa :
Lagja 4 , Rruga "Egnatia"
Mbrapa Qendres Tregetare
"Blu Star" Durres

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2013 se bashku me shenimet shoqeruese
Shumat ne mije Leke (permdryshe shkruhet)

**PASQYRA E TE ARDHURAVE TOTALE GJITHEPERFSHIRESE PER PERIUDHEN QE FILLOI ME
1 JANAR DERI ME 31 DHJETOR 2013**

	shen	31-Dec-2013	31-Dec-2012
Te ardhurat- Furnizimi Me Uje & Largim Ujrash (neto nga Tarifat Rrgullatore)	8.1	704,324,482	666,794,322
Te Ardhura te Tjera Lidhura me Sherbimin	8.2	72,140,019	57,896,911
Te Ardhura te Tjera	8.3	10,811,189	26,760,637
Ardhurat Totale		787,275,690	751,451,870
Shpenzimet Operative			
Shpenzimet e Prodhimit	9	419,988,082	390,001,679
Shpenzimet Operim Mirembajtje	10	117,591,732	110,750,280
Shpenzimet e Shitjes	11	37,027,425	22,689,772
Amortizimi, zhvleresimi dhe harxhimi	19	105,432,067	376,362,659
Kosto e Aktiveve te Nxjerra Jashte Perdorimit ose Shitura		380,800	8,980,551
Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative	12	20,628,683	18,197,956
Shpenzime Personeli	13	275,075,972	255,481,295
Shpenzimet Operative		975,743,961	1,173,483,641
Rezultati Operativ		(188,468,271)	(422,031,771)
Te Ardhurat/Shpenzimet Financiare			
Ardhura nga Grantet	14.3	412,720,057	809,287,568
Te Ardhurat financiare	14.1	18,884	252,268
Shpenzimet financiare	14.1	(23,202,447)	(20,054,567)
Fitim (humbje) nga kembimit valutore	14.2	33,988,451	0
Shpenzimet e Humbjes Vleres Aktiveve Materiale			
Shpenzimet e Humbjes Vleres Aktiveve Materiale	18	(90,856,428)	0
Shpenzime te tjera Financiare (Humbje Vlere Aktiveve Financiare)	17	(196,041,461)	0
Te Ardhurat/Shpenzimet Financiare		136,627,057	789,485,269
Fitim (humbje) para tatimit mbi fitimin		(51,841,214)	367,453,498
Shpenzimi I tatim Fitimit	15	(33,341,382)	(24,132,426)
Shpenzim Tatim Fitimit Korrent	694	0	24,132,426
Tatim I Shtyre detyrim (Aktiv)		33,341,382	
Fitim (Humbje) neto		(85,182,596)	343,321,072
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese			
Fitime Humbje te njohura ne Kapital			
Transferime ne llogarite e Rezerves se rivleresimit			
Te ardhura te tjera gjitheperfshirese , pas tatimit			
Totali i fitimit per periudhen ushtrimore		(85,182,596)	343,321,072

Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shoqeruese 1-28

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2013 se bashku me shenimet shoqeruese
Shumat ne mije Leke (perndryshe shkruhet)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR PER PERIUDHEN QE U MBYLL ME 31 DHJETOR 2013

	shen	31-Dec-2013	31-Dec-2012
Aktivet Afatshkurter			
Mjetet Monetare dhe te Ngjashme	16	54,912,247	18,359,315
Llogarite e Arketueshme	17	600,599,234	2,605,959,167
Inventaret	18	903,026	90,131,167
		656,414,507	2,714,449,649
Aktivet AfatGjate			
Toka, Terrene, Ndertesa	19	515,307,889	457,611,637
Instalime Specifike	19	1,793,700,612	598,677,387
Makineri dhe Pajisje tjera	19	172,893,688	75,022,897
Aktive te tjera Afatgjata	19	71,682,735	183,581,406
Aktive Afatgjata Financiare	22	0	1,206,015,776
		2,553,584,924	2,520,909,103
		3,209,999,431	5,235,358,751
Detyrime Afatshkurter			
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlllogaritura	20	560,921,917	569,407,613
Detyrime ndaj personelit	21	9,105,763	13,489,878
Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH	21	6,785,811	7,720,333
Huamarrje afatshkurter (Mfin Int)	22	223,933,222	0
Huamarrje afatshkurter (Mfin Princ)	22	428,516,569	0
		1,229,263,282	590,617,824
Detyrime AfatGjate			
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlllogaritura			
Huamarrje Afagjate	22	1,731,761,814	2,794,326,570
Detyrime te Tjera Afatgjata dhe te ardhura te shtyra	23	384,112,263	376,375,946
Detyrime te Tjera (Tatimi i Shtyre)	15	64,885,223	33,443,841
Provizione			
		2,180,759,300	3,204,146,357
Llogarite e Kapitalit Aksioner			
Kapitali i paguar		446,968,000	446,968,000
Reserva		514,229,468	514,229,468
Fitimi(humbja) e Mbartur		(1,161,220,619)	479,397,102
	24	(200,023,151)	1,440,594,570
		3,209,999,431	5,235,358,751

Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shoqeruese 1-28

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2013 se bashku me shenimet shoqeruese
Shumat ne mije Leke (permdryshe shkruhet)

**PASQYRA E NDRYSHIMIT TE FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE PER PERIUDHEN QE FILLOI
ME 1 JANAR DERI ME 31 DHJETOR 2013 (metoda indirekte)**

	shen	31-Dec-2013	31-Dec-2012
Fitim (Humbja) Pas Tatim Fitimti		(51,841,214)	367,453,498
Efektet Korrigjuese te Flukseve Operative			
Amortizimi, Zhvleresimi		105,432,067	376,362,659
Diferenca Kembimi		(22,664,598)	(21,609,023)
Amortizimi Grantit		(6,210,791)	0
Ardhura nga Interesi		(18,884)	(96,209)
Shpenzime Interesei		23,202,447	20,054,567
Humbja nga Fshirja e logariv ete Arketueshme		(1,223,799,889)	
Humbja nga testi Vleres Llogarive te Arketueshme		196,041,461	0
Humbja nga Testi Vleres se Inventarit		90,856,428	0
Pakesim /(Rritje) Llogarite e Arketueshme		959,524,876	(224,303,401)
Pakesim /(Rritje) Llogarite e Arketueshme Tjera		(27,132,435)	(27,999,645)
Pakesim /(Rritje) Inventaret		(16,428,989)	2,911,010
Rritje /(Pakesim) i Furnitoreve		(8,485,696)	(178,683,720)
(Rritje /(Pakesim) I Ppersonelit dhe Detyrimet ndaj shtetit dhe Personelit		(5,318,637)	15,315,672
(Rritje /(Pakesim) Intersat Arketueshem		18,884	96,209
(Rritje /(Pakesim) Intersat Pagueshem		(23,202,447)	(20,054,567)
(Rritje /(Pakesim) Huamarrje Afatshkurer		652,449,791	0
(Rritje /(Pakesim) Tatim		31,441,382	23,632,426
Mjetet Monetare qe rrjedhin nga Aktiviteti Operati		673,863,755	333,079,476
Blerje Aktiveve Afatgjata Materiale		(138,107,888)	(812,283,101)
Kredi dhe paradhanie te dhena paleve te lidhura			
Mjetet Monetare qe rrjedhin nga Aktiviteti Investues		(138,107,888)	(812,283,101)
Financing activities			
Korrigjime te Vlerave te Humbjes Mbartur		(96,824,286)	427,330,347
(Rritje /(Pakesim) Huamarrje Afatgjate		(410,114,965)	
((Rritje /(Pakesim) Huamarrje Plaet e Lidhura			
Grantet		7,736,317	47,017,395
Mjetet Monetare qe rrjedhin nga Aktiviteti Financues		(499,202,934)	474,347,742
Rritje/(Pakesim) i Mjeteve Monetare gjate periudhes		36,552,933	(4,855,883)
Mjete Monetare ne Fillim te periudhes		18,359,315	23,215,197
Mjete Monetare ne Fund te Periudhes	22	54,912,248	18,359,315

Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shoqeruese 1-28

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2013 se bashku me shenimet shoqeruese
Shumat ne mije Leke (perndryshe shkruhet)

**PASQYRA E NDRYSHIMIT TE KAPITALIT AKSIONER PER PERIUDHEN QE FILLOI ME
1 JANAR DERI ME 31 DHJETOR 2013**

	Kapitali Aksioner	Rezerva Tjera	Rezerva Ligjore	Rezerva te Rivleresimit te Aktiveve	Ndryshim/Gabime ne Politikat Kontabel	Fitimi i Pashperndare	TOTALI
Gjendja me 31 dhjetor 2011	446,968,000			104,476,823		136,029,491	687,474,314
Rezultati i Periudhes						343,321,072	343,321,072
Fitime Humbje te trasferuara ne PASH							-
Fitime Humbje te trasferuara ne PASH							-
Diferenca nga Kembimi						0	0
Shumat e Njohura direkte ne kapital	0	0	0	0	0	343,321,072	343,321,072
Rezultati neto per periudhesn qe u mbyll me 31 dhjetor 2012	0	0	0	0	0		-
Rritje kapitali							-
Pagesa Dividenti				409,752,645			409,752,645
Shitesa/Pakesime Rivleresim Aktivitet							-
Ndryshime ne Diferenca konvertimi te kapitalit							-
Shperndarje e Fitimit						46,538	46,538
Fitimi (Humbje) e mbartur						479,397,102	1,440,594,570
Gjendja me 31 dhjetor 2012	446,968,000	-	-	514,229,468	-	(85,182,596)	(85,182,596)
Rezultati i Periudhes							0
Fitime Humbje te trasferuara ne PASH							0
Fitime Humbje te trasferuara ne PASH							0
Korrigjim Celja						(1,555,435,125)	(1,555,435,125)
Diferenca nga Kembimi						(1,555,435,125)	(1,555,435,125)
Shumat e Njohura direkte ne kapital	0	0	0	0	0	(1,640,617,721)	(1,640,617,721)
Rezultati neto per periudhesn qe u mbyll me 31 dhjetor 2013	0	0	0	0	0		-
Rritje kapitali							-
Pagesa Dividenti							-
Pakesim Zbritje Vlere Aktive							-
Financiare -Kliente							-
Ndryshime ne Diferenca konvertimi te kapitalit							-
Shperndarje e Fitimit							-
Fitimi (Humbje) e mbartur						(1,161,220,619)	(200,023,151)
Gjendja me 31 dhjetor 2013	446,968,000	0	0	514,229,468	0		

Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shoqeruese 1-28

Pasqyrat Financiare se bashku me shenimet shoqeruese te Ujesjelles Kanalizime Durrës Sha jane aprovuar nga keshilli
Mbikqyres dhe autorizuar per publikim me date _____

Drejtori i Pergjithshem

Emer mbiemer

[Signature]
Firma

Shefi i Kontabilitetit

Emer mbiemer

Firma

1. Te përgjithshme

1.1 Informacion Ligjor

Ujesjelles Kanalizime Durrës Sha (‘Kompania’) është krijuar me vendimin e gjykatës Durrës nr. 24509/0 date 30/08/2000 ne vijim te vendimit te Gjykates se Rrethit Durrës, bazuar ne vendimin e aksionerit te vetem, Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit per Krijim e Ndermarrjes Ujesjelles Kanalizime Qytet Sha, me kapital aksioner prej leke 261.772.000 Akione 261.772 me vlere nominale Lek 1000/aksion, teresisht i paguar me kontribute ne natyre. Kompania operon ne aktivitetin e Furnizimi me uje te pijshen te konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtje e sistemit (edhe)te furnizimit me uje te pijshem, prodhimi dhe dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve, sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura dhe shitja e tij, mirembajtja e sistemeve te ujerave te ndotura, si dhe impianteve te pastrimit të tyre.

Krijimi i saj eshte realizuar ne baze urdherit te Ministrit te Ekonomise dhe Privatizimit, vendim i marre ne vijim te nenit 2, te ligjit nr 8237 date 01.09.1997 “ Per disa ndryshime te Ligjit nr 7926 date 20.04.1995 “ Per Transformimin e Ndermarrjeve Shteterore ne Shoqeri Tregetare , i ndryshuar me dekretin Nr 1195 date 14.08.1995, Ligin Nr 8099 date 28.03.1996, dekretin 1631 date 1.11.1996 dhe ligin 8158 date 7.11.1996, ligjin nr 8158 date 7.11.1996”, dhe VKM Nr 58 date 24.2.2000 “ per Kriteret e Vleresimit te Kapitalit Themeltar te shoqerive shteterore qe do tekrijohen nga shndërrimi i ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare”.

Në 27 Dhjetor 2007 me Numri i ceshtjes: CN-109836-12-07. Kuota qe mbahej nga aksioneri i vetem Ministria e Ekonomise dhe Industrise te Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Durrës, u transferua në pronësi të njërive vendore të zonës së shërbimit që përbëhet nga 5 bashki dhe 10 komuna. Aksioneret ne UKD jane si vijon:

Aksioneri	Nr Aksioneve	Vlera e Kapitalit	% Pjesmarrjes
Bashkia Durrës	244,491.00	244,491,000.00	54.700%
Komuna Rrashbull	32,181.69	32,181,690.00	7.200%
Bashkia Sukth	29,946.85	29,946,850.00	6.700%
Komuna Thumane	20,560.52	20,560,520.00	4.600%
Kumuna Xhafzotaj	20,113.56	20,113,560.00	4.500%
Komuna Katund I Ri	19,219.62	19,219,620.00	4.300%
Bashkia Shijak	16,090.84	16,090,840.00	3.600%
Bashkia Manez	11,174.20	11,174,200.00	2.500%
Komuna Fush-Kuqe	10,724.23	10,724,230.00	2.399%
Komuna Bubq	9,833.29	9,833,290.00	2.200%
Bashkia Vore	8,939.36	8,939,360.00	2.000%
Komuna Maminas	8,492.39	8,492,390.00	1.900%
Komuna Gjepalaj	7,151.48	7,151,480.00	1.600%
Komuna Ishem	4,469.68	4,469,680.00	1.000%
Komuna Preze	3,575.74	3,575,740.00	0.800%
	446,964.45	446,964,450.00	100.000%

Liçensa e shoqërisë është rinovuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Ujit me vendim Nr 19 datë 22 prill 2013, pas një procesi monitorimi dhe vlerësimi të përmbushjes së të gjitha kërkesave për këtë liçencë nga Enti Rregullator i Ujit ne baze te Ligj Nr. 8102 date 28.03.1996 “Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”.

Kompania ne baze te numrit te ceshtjes: ka rregjistruar prane QKR administrator ligjor, Z. Spartak Kovaçi me mandat 3 vjecar nderkaq qe ajo mbikqyret nga Keshilli Mbikqyrës.

Adresa ligjore e saj është në Rr” Dlip Peza” Lgij 17, Durrës, shoqëria është subjekti i regjistruar në TVSH dhe është pajisur me NIPT J61819502V. Me 31 Dhjetor 2013 shoqëria ka 589 punonjes (31 Dhjetor 2012: 548).

Pasqyrat Financiare jane aprovuar dhe autorizuar per t’u perdorur nga Keshilli Mbikqyres me date **07/06/2014**.

1.2 Informacion mbi veprimtarine

a. Informacion mbi produktet kryesore dhe sherbimet e UKD

Bazuar ne vendimin Nr. 19 te KKRR ne date 22.04.2013. te Entit Rregullator te Sektorit te Furnizimit me Uje, eshte e vlefshme deri me dt. 21.04.2017 Objekti i Licenses sipas Ligjit Nr. 8102, date 28.03.1996 „Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujrave te ndotura” si dhe VKM nr. 958, date 06.05.2009 “Per miratimin e kategorive te licencimit dhe te procedurave per aplikim per liçence.....” eshte kryeje veprimtarine perkatese te kualifikuar ne kategorite:

- Kategoria A, Per grumbullimin dhe shperndarjen e ujit per konsum publik.
- Kategoria C, Per largimin e ujrave te ndotura
- Kategori D: Per Trajtimin e ujrave te ndotura

ne zona e sherbimit te ketej operatori eshte:

Bashkia: Durrës, Shijak, Vorë, Sukth, Manëz

Komuna: Prezë, Maminas, Gjepalaj, Katund i ri, Fushë Kuqe, Bupq, Ishëm, Thumane, Xhafzotaj , Rrashbull

Shoqeria eshte ne proces te rilicensimit si pasoje e:

- Ndryshimit te Administratorit
- Ndryshimit te Drejtuesit Teknik
- Mbarimi i afatit te vlefshmerise se Tarifes per Kategori D: Per Trajtimin e ujrave te ndotura , ne date 21.04.2014

Persa bazuar ne license UKD ofron sherbimet e meposhtme:

- i) furnizimin e ujit te pijshem
- ii) installimin e matesve
- iii) instalimin e pikelidhjeve me rrjetin
- iv) azhurnimin e rrjetit
- v) largim e ujrave te ndotura
- vi) trajtim i ujrave te ndotura
- vii) shitjen e ujit me bote
- viii)etj

Sherbimet e sherbimeve cmimet e te cilave jane te rregulluara jane:

- i) furnizim e ujit te pijshem
- ii) largim e ujrave te ndotura
- iii) trajtim i ujrave te ndotura

Per sherbimet e tjera Shoqeria aplikon çmime te cilat perlllogariten mbi bazen e kosos plus marzhi dhe qe aprovohen nga Keshilli Mbikqyres me propozim te Drejtorise.

2. Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare pergatiten duke u bazuar ne koston historike, me perjashtim te disa kategorive te aktiveve dhe detyrimeve, ne perputhje me Standartet Kombetare te Raportimit Financiar. (SKK).

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SKK kerkon qe te perdoren disa vleresime kontabel te rendesishme. Gjithashtu kerkohet qe Drejtimi te ushtrojë gjykimin e vet persa i perket politikave kontabel qe aplikohen ne kompani. Keto fusha perfshijne një shkallë të lartë gjykimi dhe kompleksiteti, ose janë fusha ku supozimet ose vlerësimet janë të domosdoshme për pasqyrat financiare te konsoliduara.

Kompania zbatoi per here të pare SKK per pergatitjen dhe prezantimin e Pasqyrave Financiare per periudhen ushtrimore qe perfundon ne 31 dhjetor 2008.

Ato perfshijne standartet e aprovuara nga Ministri i Financave, me propozim te Keshillit Kombetar i Kontabilitetit (KKK) dhe interpretimet e standarteve të botuara nga Komiteti i Interpretimeve të Standarteve të Raportimit Financiar.

3. Politikat Kontabel

3.1 Raportimi i Segmeneve te Biznesit

Një segment biznesi është një grup aktivesh dhe veprimtarish të cilat bëjnë të mundur përftimin e mallrave ose shërbimeve që janë subjekt i rreziqeve dhe përfitimeve të cilat janë të ndryshme nga ato të segmenteve të tjera të biznesit. Një segment gjeografik bën të mundur përftimin e mallrave ose të një shërbimi brenda një mjedisi të caktuar ekonomik të cilat janë subjekt i rrezikut dhe përfitimeve të ndryshme nga ato të një segmenti tjetër i cili operon në mjedise të tjera ekonomike.

Kompania eshte e angazhuar ne aspektet kryesore te Kompania operon ne aktivitetin e Furnizimi me uje te pijshen te konsumatoreve dhe shitja e tij.Mirembajtje e sistemit (edhe)te furnizimit me uje te pijshem, prodhimi dhe dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve, sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura dhe shitja e tij, mirembajtja e sistemeve te ujerave te ndotura, si dhe impianteve te pastrimit të tyre.

UKD Sha drejton aktivitetin e tij nepermjet 2 segmenteve kryesor, **Aktivitet e Rregulluara**(ne te cilat perfshihen shpendarjen e ujit te pijshem, installimin e matesve ,instalimin e pikelidhjeve me rrjetin ,azhornimin e rrjetit , largim e ujrave te ndotura ,shitjen e ujit me bote **dhe Aktivetet e Parregulluara** (shitja e ujit me Bote, Pastrimi i Kanaleve /Pusetave me Bote, mirembajtje per llogari te te treteve etj) dhe **veprimtaria e administrative e Kompanise**.

3 Politikat Kontabel (vijon)

3.2 Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj

(i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia (“monedha funksionale”). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është dhe monedha e paraqitjes.

(ii) Transaksionet dhe tepricat

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj date. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “të tjera të ardhura (shpenzime) financiare”.

Date / Currency	31 dhje 2013	31 dhje 2012
Euro	140.2	139.59
USD	101.86	105.85
SDR	156.86	162.69

3.3 Njohja e te Ardhurave

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitjet neto dhe të ardhurat nga shërbimet të realizuara nga aktivitetet kryesore të Shoqërisë, duke mos përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Pjesa më e madhe të shitjeve të Shoqërisë gjenerohen nga shitja e shërbimeve të instalimit dhe mirembajtjes.

i) Të ardhurat nga shitja e shërbimeve dhe produkteve

Në marrëveshjet për shitjen vetëm të shërbimeve, të ardhurat nga shërbimet e furnizimit me uje të pijshëm dhe shërbimet e kanalizimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimit, bazuar në matjen që realizohet të konsumit.

Të ardhurat nga shërbimet e mirëmbajtjes dhe azhurnimit, si dhe të shitjes së produkteve : ie matesave, librezave të ujit etj njihen në momentin e realizimit të tyre.

Përgjithësisht, të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose që do të arkëtohet. Në rastin kur një pagesë e shtyrë ka një ndikim të rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së drejtë, do të llogaritet duke skontuar pagesat e ardhshme. Vlerësimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse do të njihen ose jo të ardhurat ose shpenzimet. Si pjesë e procesit të njohjes së të ardhurave, UKD vlerëson nëse do të rrjedhin përfitime ekonomike të lidhura me transaksionin. Nëse UKD ka pasiguri nëse do të hyjnë apo jo përfitime ekonomike, njohja e të ardhurave shtyhet dhe njihen mbi baza monetare. Megjithatë, nëse ka pasiguri rreth mbledhjes së një shume tashmë të përfshirë në të ardhurat, shuma në lidhje me të cilën është e pamundur që të arkëtohet ajo njihet si shpenzim në zërin e kostos së mallrave të shitura.

ii) Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi njihen në proporcion me kohën duke u bazuar në metodën e interesit efektiv. Kur një Llogari e arkëtueshme është vështirë për t’u arkëtuar, UKD zvogëlon vlerën e mbartur deri në vlerën e rekuperueshme, duke konsideruar që flukset e ardhshme të parashikuara të skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të instrumentit, dhe vazhdon të pakësojë zbritjen duke njohur të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi në rastin e huave të cilat kanë rënie të vlerës njihen duke përdorur normën efektive origjinale të interesit.

3. Politikat Kontabel (vijon)

iii) Të ardhurat nga Grantet

Qeveria e Shqiperise ose dhe Organizma Nderkombetare ofrojne Grante shoqerise ne lidhje realizmin e investimeve ne infrastrukturen e rrjeteve. Fillimisht Granti njihet si detyrim ne Pozicionin Financiar nderkaq qe shuma e Grantit njihen ne te ardhura me realizmin e investimit ose shpenzimeve per realizmin e tyre. Gjithashtu Bashkite dhe Komunitat mund te japin grante per kompensimin e cmimit te ujit apo sherbimeve te rregulluara , ne keto raste te ardhurat njihen ne propocion me sasine e ujit apo sherbimeve te rregulluara qe konsumohen. Ne rastin ku ofrohen grante per mbulimin e shpenzimeve te UKD ato njihen ne te ardhura ne masen e shpenzimit te realizuar.

3.4 Makineri dhe Pajisje Pune te Ujesjellesit dhe Kanalizimet, Makineri dhe Pajisje Pune Te Tjera dhe Aktive jomateriale

[A] Njohja Fillestare

Ne zerin Ndertesat, makinerite dhe pajisjet e punes se Ujesjelles dhe Kanalizime, Aktivitet e tjera, shpenzimet kryesore te studimeve dhe zhvillimit te Puseve, dhe aktivet jomateriale njihen fillimisht vetem ato elemente per te cilat kostoja mund te matet ne menyre te besueshme dhe pritet te sjellin perfitime ekonomike ne te ardhmen per kompanine.

Aktivitet jo materiale perfshijne emrin e mire, koston e kapitalizuar te software-ve dhe markave. Gjate fazes se ndertimit te ndertesave, makinerive dhe pajisjeve shuma e interesit kapitalizohet si rritje ne vleren e aktivitetit.

Ndertesat, makinerite dhe pajisjet dhe aktivet jomateriale njihen me kosto pasi jane zbritur amortizimi , zhvleresimi i akumuluar apo ndonje renie ne vlere.

Ne lidhje me infrastrukturen qe ndertohet nga UKD per perdorim gjate aktivitetit , koston qe perfshihen jane :

- Materialet
- Puna direkte
- Sherbimet nga nenkontraktoret
- Sherbimet e mbikqyrjes
- nese ekzistojne detyrime per shkaterrimin e pajisjeve dhe pastrimin e ambjentit ne te cilat installohen shuma e perlllogaitur e ketyre shpenzimeve
- nje mase prej rreth 8% e shpenzimeve administrative

Kosto e huamarrjes gjithashtu perfshihet ne koston e ndertimit atehere kur UKD ka marre kredi per ndertimin e aktiveve. Koston e ndertimit njihen fillimit si Aktiv Ne Process dhe me pas riklasifikohen ne aktive me perfundimin dhe venien ne pune te aktivitetit ne menyren qe eshte percaktuar nga drejtimi.

Ne rast se gjate aktivitetit realizohen shpenzime ne lidhje me inspektimin e aktiveve atehere ky shpenzim shtyhet dhe njihet gjate periudhes deri ne inspektimin e ardhem vetem atehere kur matet ne menyre te besueshme..

[B] Zhvleresimi dhe amortizimi

Ndertesat, makinerite dhe pajisjet e lidhura me aktivitetin e ujesjelles kanalizime amortizohen bazuar ne jetegjatesine e aktivitetit, ne keto raste per amortizimin e tyre perdoret metoda lineare. Baza e perlllogaritjes perfshin shumen fillestare te Makineri dhe Pajisje dhe duke zbritur vleren e rikuperueshme te aktivitetit.

Ndertesa, makineri dhe pajisje te tjera zakonisht jane zhvleresuar me metoden lineare ne baze te jetes te dobishme te tyre qe zakonisht perlllogaritjet mbi jetegjatesine e supozuar te aktivitetit: Jetegjatesia e aplikuar e aktive te UKD eshte percaktuara ne Vendimin Nr 11 date 30/04/2012 e Keshillit Mbikqyrjes i cili paraqet sa me poshte vijon:

3 Politikat Kontabel (vijon)

Lloji	Perqindja e Amortizimi 2013	2012
Troka, Terrene , Troje dhe Permiresime	ska	ska
Rrjete Ujesjelles (ne varesi te tubazionit)	1,5%	10%
Rrjete Kanalizime	1,5	10%
Depo, Depozita dhe te ngjashme	1,5%	4%
Ndertesat dhe permiresimet	1,5%	4%
Makineri e pajisje	3%	20%
Mjete Transporti	7%	20%
Pajisje kompjuterike dhe te ngjashme	25%	25%
Inventari Ekonomik	50%	0%

Ndertesa, makinerite dhe paisjet te mbajtura me qera financiare zhvleresohen bazuar ne termat e qerase.

[C] Renia ne vlere

Vlera e mbartur e ndertesave, makineriveve dhe pajisjeve kryesore te Ujesjelles dhe Kanalizime jane testuar cdo vit per renien ne vlere te mundeshme, ateher kur ngjarjet apo kushtet e gjendjes financiare e tyre tregojne qe shuma e mbartur e ketyre aktive nuk mund te rikuperohet.

Ne Rast se per Aktivet identifikohen qe mbartin nje renie ne vleres se tyre ateher shuma e mbartur ne kontabilitet zvogelohet deri ne shumen e rekuperueshme. Shuma e rekuperueshem perfaqesohet nga shuma me e madhe midis vleres se drejte minus kostot e shitjes dhe vleres ne perdorim, ku kjo e fundit eshte llogaritur si vlera e skontuar e flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te rregulluara nga faktoret e riskut qe mbartin.

Per kete arsye grupohen sipas aftesise se tyre per te gjeneruar flukse hyrese te parase bazuar ne faktin qe keto aktive jane te identifikueshem vecmas dhe qe gjenerojne flukse te rendesishem mjetesh monetare. Aktivet e klasifikuara si te mbajtura per shitje jane njohur me vleren me te voglen ndermjet vleres se mbartur dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Nuk ngarkohet asnje tjeter provizion per zhvlersimin per aktive te tille.

Vleresimet e flukseve te ardhshem te parase te perdorur ne vleresimin e renies ne vlere te aktiveve te lidhura me prodhimin dhe shpendarjen e produkteve te ujesjelles kanalizimeve kryhet duke perdorur vlersimin e riskut ne lidhje me prodhimin dhe performancen e tyre .

Zbritja ne Vlere e aktiveve, pervec emrit te mire, aplikohet sa here qe ngjarjet qe kane cuar ne kete renie te vlereses ndryshojne. Shtimet apo pakesimet e renies ne vlere raportohen se bashku me zhvlersimin, harxhimin, dhe amortizimin.

3 *Politikat Kontabel (vijon)*

3.5 *Inventaret*

Inventari i vleresohet me te vogel ndermjet kosos historike dhe vleres neto te realizueshme .

3.6 *Tatimi i shtyre*

Tatimet e shtyra llogariten ne perputhje me metoden e detyrimeve per tatim fitmin ne baze te dispozitave dhe ligjeve qe jane ne fuqi ne daten e bilancit kontabel.Tatimi i shtyre njihet per te gjitha diferencat qe lindin midis bazes se taksueshme te akiveve dhe detyrimeve te njohura ne Pasqyrat Financiare dhe vleres se tyre te mbartur (diferencat e perkohshme); tatimi i shtyre nuk njihet pergjithsisht ne njohjen fillestare te nje aktivi apo pasive ne nje trasaksion qe nuk ka ndikim as ne fitimin kontabel as ne fitimin e tatueshem. Aktivet per tatimet e shtyra njihen atehere kur ka sguri se do te realizohen perfitime nga tatimi ne te ardhmen. Aktivet dhe detyrimet per tatimet e shtyra nuk skontohen dhe ato paraqiten te ndara ne Bilancin Kontabel pervec kur bie ne kontrast me ligjet ne fuqi.

3.7 *Tatimi aktual*

Norma aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet bazuar në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël ne lidhje me shoqerite qe kryejne aktivitetin ne fushen e hidrokarbureve. Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

3.8 *Perfitimet e punonjesve*

A Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Kompania paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat bëjnë të mundur përfitimin e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për të përcaktuar vlerën minimale për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore për qëllime të pensionit duke u bazuar në një skemë të pensioneve me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Kompanisë në skemën e përfimit të pensionit regjistrohen si shpenzime kur ato përlllogariten.

3.9 *Instrumentat financiar dhe c'rregjistrimi i tyre*

Kompania përdor instrumenta financiare për të manaxhuar dhe zvogëluar rrezikun e ekspozimit ndaj luhatjeve të normave të interesit dhe kurseve të këmbimit të monedhave.

3.9.1 *Aktivt financiar*

Kompania i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: Huadhëniet dhe të Arkëtueshmet të cilat klasifikohen në Llogaritë e arkëtueshme, ndërsa Investimet klasifikohen si të mbajtura deri në maturim. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare.

A. *Hua dhe Paradhënie*

Huatë dhe Paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativ me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk kuotohen në një treg aktiv, përveç rasteve kur: (a) ato që Kompania planifikon ti shesë menjëherë ose në afatshkurtër, të cilat janë të klasifikuara si të mbajtura per tregtim, dhe ato që Kompania që në momentin e parë i klasifikon si vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes; (b) ato që Kompania i kalsifikon si të disponueshme për shitje; ose (c) ato që mbajtësit nuk mund të rikuperojë tërësisht gjithë vlerën e investimit fillestare, përveç rastit të përkeqësimit të indeksit të kreditit.

3 Politikat Kontabel (vijon)

Huatë dhe Paradhënie njihen kur Kompania u bë pjesë e një marrëveshjeje kontraktuale. Huatë dhe Paradhëniet fillimisht maten me kostot duke përfshirë çdo transaksion kostoje të ndodhur, ndërsa më pas maten me koston e amortizuar minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

B. Llogari të Arkëtueshme

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë para. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen me koston e amortizuar pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Llogaritë e Arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionet për rënie të vlerës.

C. Investimet te mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturim të fiksuar, për të cilat Drejtimi ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Nëse Kompania do të shiste një vlerë të rëndësishme të aktiveve të mbajtura deri në maturim, atëherë e gjithë kategoria do të riklasifikohet si te disponueshme për shitje.

Investimet e mbajtura deri në maturim njihen në datën e marrëveshjes dhe maten me koston fillestare duke përfshirë të gjitha transaksionet me kosto për këtë aktiv. Më pas maten me koston e amortizuar minus çdo humbje nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto e amortizuar matet me metodën e normës efektive të interesit. Primi dhe vlerat e skontuara, duke përfshirë kostot fillestare të transaksionit, përfshihen në vlerën e mbartur të instrumentit përkatës dhe amortizohen duke u bazuar në normën efektive të interesit të instrumentit, kur aplikohet.

3.9.2 Detyrimet financiare

Kompania i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese: Llogari të pagueshme dhe detyrime financiare.

A. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

B. Huamarrja

Huamarrja njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Kompania ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

3.9.3 Zhvlerësimi i Aktiveve Financiare

A. Aktivet e mbartura me koston e amortizuar

Kompania vlerëson në çdo datë të bilancit nëse ka evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet dhe humbjet e zhvlerësimit ndodhin vetëm nëse ka evidenca objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit (një 'ngjarje humbjeje') dhe që një ngjarje humbjeje (ose disa ngjarje) kanë ndikim mbi flukset monetare të parashikuara të aktivit dhe që mund të vlerësohet me efektivitet. Periudha përkatëse mes një humbjeje dhe identifikimit të saj përcaktohet nga drejtimi.

3 Politikat Kontabel (vijon)

Në përgjithësi, periudhat e perdorura variojnë nga tre në 12 muaj; në raste të veçante përdoren periudha më të gjata. Nje provizion per renie vlere te Huave dhe Llogarive te arketushme krijohet atehere kur eshte evidente qe Kompania nuk do te jete ne gjendje qe t'i arketoj te gjitha shumat ashtu sic ishte parashikuar ne termat fillestare të Huave dhe të Llogarive të Arkëtueshme. Konsiderohen tregues te renies se Vleres se Huave dhe Llogarive te arketueshme: Vështiresi te rendesishme financiare te debitorit, ndoshta debitori ka hyre ne rruget e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat ne pagesa. Shuma e provizionit është diferenca mes vlerës së mbartur të aktivitetit dhe vleres aktuale te flukseve te parashikuara te ardhshme te parave, të skontuara me normën origjinale efektive të interesit. Vlera e mbartur e aktivitetit zvogelohet duke perdorur nje llogari Zbritje te vleres, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ne zerin e shpenzimeve te shitjes dhe administrimit. Kur ndonje Hua ose Llogari e Arkëtueshme nuk mund te arketohet, ajo crregjistrohet ne debi te Llogarise Zbritje te vleres dhe ne kredi te Llogarise te arketueshme. Nese me pas arketohet shuma te cilat jane crregjistruar , atehere kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit per keto shuma.

3.9.4 Çrregjistrimi i Instrumentave Financiare

Një aktiv financiar sipas përkufizimit të SNK32 “Instrumentat financiare: Shënime shpjeguese dhe Paraqitja” crregjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Kompania parashikon që nuk do gjenerohen më flukse parash nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Kur kemi të bëjmë me mosarkëtim nga klienti, në rastin e Llogarive të arkëtueshme, dhe kryejmë një transferim të gjithë risqeve dhe shpërblimeve që lidhen me pronësinë, atëhere kjo llogari klasifikohet për një transferim, duke bërë të mundur kështu që kjo Llogari e arkëtueshme të jetë e vlefshme për crregjistrim, duke supozuar që pagesa me vonesë përbën një risk të parëndësishëm. Një interpretim më i ngushtë i konceptit të “transferim thelbësor i rreziqeve dhe përfitimeve” mund të vendosë në pikëpyetje trajtimin kontabël që është adoptuar.

3.10 Qerate

Kompania, kryesisht hyn në marrëveshje për qira operative. Pagesat totale te kryera sipas kontratës së qirasë operative regjistrohen si shpenzime të periudhës duke u shpërndarë përgjatë jetëgjatësisë së kontratës, duke u bazuar në metodën lineare, dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. Kur qiraja operative përfundon përpara afatit të qirasë, çdo pagesë që i bëhet qiradhënësit në formën e penaliteteve për mbylljen e kontratës përpara afatit, regjistrohet si shpenzim në periudhën kur ndodh përfundimi i kontratës.

3.11 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare

Në përputhje me SKK2 “Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare”, Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin paranë (arkëtimet në para dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak) Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollat e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrespondojnë me Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

4. Menaxhimi i Riskut

4.1 Manaxhimi riskut financiar

Aktivitetet e Kompanisë janë të ekspozuara ndaj një shumëllojshmërie risqesh financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizat, vlerësimin, pranimin dhe manaxhimin e disa shkallëve të riskut ose kombinime të risqeve. Marrja përsipër e riskut është thelbësore për bizneset financiare, dhe risqet operationale janë pasoja të paevitueshme e të qënurit biznes. Prandaj, qëllimi i Kompanisë është të arrijë një balancë të përshtashme midis riskut dhe kthimit dhe të minimizojë efektet potenciale të kundërta në performancën financiare të Kompanisë. Manaxhimi i riskut zbatohet nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Finances. Ky department identifikon, vlerëson dhe mbrohet ndaj risqeve financiare në bashkëpunim të ngushtë me Drejtuesin e Kompanisë. Kompania zbaton parimet në lidhje me manaxhimin e riskut të përgjithshëm dhe politikat e shkruara që mbulojnë fusha të specifike, të tilla si risku nga kursi i këmbimit, risku i normave të interesit, risku i kreditimit, risku operacional etj.

Bordi i Drejtoreshve të kompanisë ka të gjithë përgjegjësinë për përpilimin dhe aprovimin e politikave të manaxhimit të riskut. Bordi ka implementuar dhe monitoron zbatimin e politikave të manaxhimit të riskut duke vendosur limitet perkatese të riskut dhe kontrollon dhe monitoron risqet me kushtet e tregut dhe të aktivitetit të kompanisë.

Llojet më të rëndësishme të risqeve të Kompanisë janë risku i kreditimit, risku i likuiditetit, risku i tregut dhe risqet e tjera operationale. Risku i tregut përfshin riskun e monedhës, riskun e normës së interesit dhe riskun e inflacionit.

A. Risku i tregut

Kompania është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, i cili është risku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme të Mjeteve Monetare të një instrumenti financiar do të jenë të luhatshme për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Risqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në normat e interesit, produktet e monedhës dhe të kapitalit, ku të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut dhe ndryshimeve në nivelin e paqëndrueshmërisë të normave të tregut ose çmimeve të tilla si normat e interesit, spredi i kreditimit, normat e kursit të këmbimit dhe çmimi i kapitalit. Ekspozimi i Kompanisë ndaj riskut të tregut lind nga portofolet e patregëtueshme. Portofolet e patregëtueshme përbëhen nga risqe të kursit të këmbimit që lindin nga llogaritë e arkëtueshme të Kompanisë dhe Huamarrja.

- Risku i kursit të këmbimit

Kompania ekspozohet ndaj efekteve të luhatjeve të normave ekzistuese të kursit të këmbimit në pozicionin e saj financiar dhe flukset e Mjeteve Monetare. Risqet e kursit të këmbimit lindin kur transaksionet e ardhshme tregëtare ose aktivet ose detyrimet e njohura janë të shprehura në një monedhë e cila nuk është monedha funksionale e Kompanisë LEK. Kompania ka njohur respektivisht në fund të periudhës 2013: 0 Mil leke Aktive në Valute të Huaj (2012; 0 Mil lek), detyrime në Valute të Huaj në shumën 2,400 Mil Lek (2012; 2,794 Mil lek).

Periudha qe u mbyll me 31 dhjetor 2012

	LEK	USD	Euro	Other	TOTAL
Aktivitet Afatshkurter	656,414,507	0	0	0	656,414,507
Aktivitet Afatgjate	2,553,584,924	0	0	0	2,553,584,924
Total	3,209,999,431	0	0	0	3,209,999,431
Detyrimet Afatshkurter	576,813,491	160,599,588	240,821,902	251,028,300	1,229,263,282
Detyrimet Afatgjate	448,997,486	0	833,536,217	737,813,253	2,180,759,300
Kapitali	(200,023,151)	0	0	0	(200,023,151)
Total	825,787,826	321,011,932	1,074,358,119	988,841,554	3,209,999,431
Diferenca ne fund te periudhes ,	2,384,211,605	(321,011,932)	(1,074,358,119)	(988,841,554)	(0)

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2013 se bashku me shenimet shoqeruese
Shumat ne mije Leke (perndryshe shkruhet)

Periudha qe u mbyll me 31 dhjetor 2012

	LEK	USD	Euro	Other	TOTAL
Aktivet Afatshkurter	2,714,449,649	0	0	0	2,714,449,649
Aktivet Afatgjate	2,520,909,103 0	0 #	0 0	0 0	2,520,909,103
Total	5,235,358,751	0	0	0	5,235,358,751
Detyrimet Afatshkurter	590,617,824	0	0	0	590,617,824
Detyrimet Afatgjate	409,819,787 0	2,794,326,570	0 0	0 0	3,204,146,357
Kapitali	1,440,594,570 0	0 #	0 0	0 0	1,440,594,570
Total	2,441,032,181	2,794,326,570	0	0	5,235,358,751
Diferenca ne fund te periudhes ,	2,794,326,570	(2,794,326,570)	0	0	0

4. Menaxhimi i Riskut (vijon)

- Norma e interesit te fluksit te Mjeteve Monetare dhe vleres se drejte

Kompania ka detyrime te rendesishme qe mbartin interes, nderkaq qe flukset e parase nuk jane thelbesisht te varura nga ndryshimi i normave te interesit.

- Risqe te tjera të Çmimit

A. Risku i Çmimit

Kompania eshte e ekspozuar ndaj riskut te cmimit. Ky cmim percaktohet nga Enti Rregullator i Sektorit te Funrizimit me uje te Pijshem ("ERRU") bazuar ne Ligjit Nr. 8102, date 28.03.1996 "Per kuadrin rregullator te sektorit te furnizimit me uje dhe largimit e perpunimit te ujerave te ndotura". Cmimi aktual qe perdoret per faturimin e sherbimit te furnizimit me uje dhe tarifes se sherbimit eshte percaktuar ne baze te vendimit nr 36 date 19.12.2011 te ERRU, nderkaq qe tarifa e Largimit dhe Trajtimti te Ujrave te Ndotur me vendimi nr 24 date 03.06.2013. Afati i vlefsherise se ketyre cmimeve eshte deri ne miratimin e tarifave te reja. Me qellim minimizimin e riskut te cmimit UKD aplikon prane ERRU sa here qe mendon qe duhen korrigjuar tarifat dhe qe plotesohen kushtet ligjore sipas ligjit dhe rregullave ne fuqi . Cmimet e aplikuar paraqiten si vijon:

Tarifat Viti 2013

	Tarife Uje I Pijshen	Tarife Ujrat e Perdorur	Tarife Sherbimi
Konsumator Familjar	58	35	100
Institucione Buxhetore	120	50	100
Ente Private	120	50	100

Tarifat Viti 2012

	Tarife Uje I Pijshen	Tarife Ujrat e Perdorur	Tarife Sherbimi
Konsumator Familjar	58	15	100
Institucione Buxhetore	110	20	100
Ente Private	120	20	100

Tarifat Viti 2011

	Tarife Uje I Pijshen	Tarife Ujrat e Perdorur	Tarife Sherbimi
Konsumator Familjar	45	12	
Institucione Buxhetore	90	15	
Ente Private	110	15	

4. **Menaxhimi i Riskut (vijon)**

4.2 **Risku i kreditimit**

Politika e Menaxhimit te Riskut te Kreditimit

Kompania ekspozohet ndaj riskut të kreditimit, i cili është risku që një palë e tretë do të shkaktojë një humbje financiare për Kompaninë duke mos paguar detyrimin. Risku i kreditimit është më i rëndësishmi ndaj të cilit përballet Kompania: si rrjedhim Drejtimi duhet ta manaxhojë me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kreditimit. Risku i kreditimit lind parimisht në aktivitetet e shitjes që sjellin si rezultat të drejta për t'u arkëtuar, dhe aktivitetet e investimit që sjellin Tituj të tjerë në portofolin e aktiveve të Kompanisë. Manaxhimi dhe kontrolli i riskut të kreditimit është i centralizuar në departamentin e Financës të Kompanisë dhe raportohet tek Drejtuesi i Kompanisë. Risku i kreditimit lind nga paratë dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare, depozitat në bankë dhe institucionet financiare, si dhe ekspozimi i kreditimit ndaj klientëve, duke përfshirë kërkesat për t'u arkëtuar dhe angazhimet në transakione. Për bankat dhe institucionet financiare, merret në konsideratë Vlerësimi i pavarur i bankës ose i Kompanive Mëmë. Nëse nuk ka vlerësim të pavarur, kontrolli i riskut vlerëson cilësinë e kreditit të klientit, duke marrë parasysh pozicionin e tij financiar, përvojën e kaluar dhe faktorë të tjerë. Limite individuale të riskut vendosen duke u bazuar në klasifikimet e brendshme ose të jashtme në përputhje me limet e përcaktuara nga Kompania. Respektimi i limiteve të kreditit monitorohet vazhdimisht. Më poshtë jepet një listë ekspozimi krediti; Nje prezantim i plote i riskut te kreditit eshte paraqitur me poshte;

	Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor	
	2013	2012
Arka dhe Llogari prane Bankave	54,912,247	18,359,315
Llogarite e Arketueshme	600,599,234	2,605,959,167
Total	655,511,481	2,624,318,482

4. Menaxhimi i Riskut (vijon)

4.2.1 Sistemi i Klasifikimit te Llogarive te Arketueshme

UKD SHA ka ndertuar nje sistem me ane te te cilit klasifikon aktivet financiare bazuar ne performancen e tyre si me poshte:

Grupi i Pare Kliente qe nuk kane perftuar nga Aministia -

- jane identifikuar gjithë klientet te cilet nuk kane nje gjendje per te paguar qe rrjedh nga faturimi deri ne 31 dhjetor 2007 dhe si te tille jane konsideruar si kliente qe nuk kane perftuar nga Amnistia
- gjithë klientet e rinj me te cilet UKD sha ka lidhur kontrate duke filluar nga Dat 1 janar 2008.

Grupi i Dyte -

- jane identifikuar gjithë klientet te cilet kane nje gjendje per te paguar qe rrjedh nga faturimi deri ne 31 dhjetor 2007 , ose ndryshe kane perftuar nga Aministia e Pergjithshme neni 30 pghr 1 & 2, 3-“Falja e detyrimeve te faturave te papaguara te konsumit te ujit per konsumatoret familjar” i Ligji 10418 dt 21.4. 2011 “ per legalizimin e kapitalit dhe faljen e nje pjese te borxhit doganor dhe Tatimor ref Shen. 1.

Nje paraqitje e llogarive sipas sistemit te Faturimit per grupet e mesiperme paraqitet sa me poshte:

	2011	Nuk Kane perftuar nga Amnistia	Kane perftuar nga Amnistia
Konsumatore familjare	823,193,024	166,089,438	657,103,586
Subjekte private	89,431,057	86,443,352	2,987,706
Ente buxhetore	128,091,015	50,361,128	77,729,887
Te tjera			
Totali	1,040,715,097	302,893,918	737,821,179

	2012	Nuk Kane perftuar nga Amnistia	Kane perftuar nga Amnistia
Konsumatore familjare	989,592,608	231,119,792	758,472,816
Subjekte private	101,382,016	97,401,990	3,980,026
Ente buxhetore	158,868,354	68,141,144	90,727,211
Te tjera			
Totali	1,249,842,978	396,662,925	853,180,053

	2013	Nuk Kane perftuar nga Amnistia	Kane perftuar nga Amnistia
Konsumatore familjare	1,284,926,213	340,753,308	944,172,905
Subjekte private	103,114,636	97,908,271	5,206,365
Ente buxhetore	184,785,150	83,758,411	101,026,739
Te tjera			
Totali	1,572,825,999	522,419,989	1,050,406,010

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2013 se bashku me shenimet shoqeruese
Shumat ne mije Leke (permdryshe shkruhet)

4. Menaxhimi i Riskut (vijon)

4.3 Risku i likuiditetit

Manaxhimi i kujdesëm i likuiditetit nënkupton mbajtjen gjendje të një sasive të mjaftueshme të Mjeteve Monetare dhe letrave me vlerë të tregtueshme, disponueshmëri fondesh nëpërmjet shumave të përshtatshme për angazhimet për kredidhënien dhe aftësinë për të mbyllur pozicionet në treg. Për shkak të natyrës së biznesit, Kompania është fleksibël në fondet e saj duke mbajtur gjendje paraje të mjaftueshme.

4.3.1 Maturiteti i Mbetur I Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare

UKD Ka si burim kryesor të financimit të aktiveve të saj Kapitalin e aksionereve dhe Huatë afatgjata të dhene në vijm fondit të ndihmes së qeverive të huaja Ministrise së Puneve Publike dhe Transportit (Njesise së Menaxhimit të Projekteve të Huaja). Nderkaq që kapitali nuk ka afat maturimit , dhe Llogaritë e arketueshme janë të oaguehsme deri në 30 dite , huatë afatgjata variojnë për periudha 20- 30 vjet. Tabela e mëposhtme paraqet flukset e paskontuara ndërkaj që pret flukset e parase të mos ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme nga ato të parashikuara:

Periudha që u mbyll me 31 dhjetor 2013

	Deri në 30 dite	30- 90 dite	91 - 180	181 - 365	Mbi 1 vit	TOTAL
Aktivet Afatshkurter	54,912,247	600,599,234	0	0	903,026	656,414,507
Aktivet Afatgjata	0	0	0	0	2,553,584,924	2,553,584,924
Total	54,912,247	600,599,234	0	0	2,554,487,950	3,209,999,431
Detyrimet Afatshkurter	1,229,263,282	0	0	0	0	1,229,263,282
Detyrimet Afatgjate	0	0	0	0	2,147,315,459	2,180,759,300
Kapitali	0	0	0	0	(200,023,151)	(200,023,151)
Total	1,229,263,282	0	0	0	1,947,292,308	3,209,999,431
Diferenca në fund të periudhës ,	(1,174,351,035)	600,599,234	0	0	607,195,642	(0)

Periudha që u mbyll me 31 dhjetor 2012

	Deri në 30 dite	30- 90 dite	91 - 180	181 - 365	Mbi 1 vit	TOTAL
Aktivet Afatshkurter	18,359,315	0	2,605,959,167	0	0	2,714,449,649
Aktivet Afatgjata	0	0	0	0	2,520,909,103	2,520,909,103
Total	18,359,315	0	2,605,959,167	0	2,611,040,269	5,235,358,751
Detyrimet Afatshkurter	590,617,824	0	0	0	0	590,617,824
Detyrimet Afatgjate	0	0	0	0	3,170,702,516	3,204,146,357
Kapitali	0	0	0	0	1,440,594,570	1,440,594,570
Total	590,617,824	0	0	0	4,611,297,086	5,235,358,751
Diferenca në fund të periudhës ,	(572,258,509)	0	2,605,959,167	0	(2,000,256,817)	0

4. **Menaxhimi i Riskut (vijon)**

4.4 **Manaxhimi i riskut të kapitalit**

Objektivat e Kompanisë në lidhje me manaxhimin e kapitalit janë të ruajnë aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin bazuar në parimin e vijimësisë me qëllim që të sjellë kthime për aksionerët. Me qëllim mbajtjen ose ndryshimin e strUKDurës së kapitalit. Njësoj si kompanitë e tjera që operojnë në këtë industri, Kompania monitoron kapitalin e tij mbi bazën e normës gearing. Kjo normë llogaritet si raport i borxhit neto me kapitalin total. Borxhi neto llogaritet si total i huave (duke përfshirë huatë afatgjata dhe huatë afatshkurtra të paraqitura në bilancin kontabël) minus paratë dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Kapitali total llogaritet si vlera e kapitalit që paraqitet në bilancin kontabël plus huanë neto. Normat gearing në 31 Dhjetor 2013 dhe 2012 ishin si më poshtë:

Description	31-dhjet-13	31-dhjet-12
Huaja Totale (20,21)	1,731,761,814	2,794,326,570
Minus (Mjete Monetare dhe te Ngjashme) (12)	(54,912,247)	(18,359,315)
Borxhi Neto	1,676,849,567	2,775,967,255
Kapitali Neto (22)	1,440,594,570	687,474,314
Kapitali Total	236,254,997	2,088,492,941
Gearing ratio	0.14	0.75

4. Menaxhimi i Riskut (vijon)

4.5 Vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e instrumentave financiare të tregtueshme në një treg aktiv (për shembull aktivet e mbajtura deri në maturim) përcaktohet duke përdorur çmimet e tregut në datën e bilancit kontabel. Çmimi i tregut i përdorur për aktivet financiare të mbajtura në maturim, është çmimi aktual për shitje që ka Kompania. Vlera e drejtë e instrumentave financiarë që nuk tregtohen në një treg aktiv (p.sh. llogaritë e arkëtueshme) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Kompania përdor një shumëllojshmëri metodash dhe vendos supozime të cilat janë të bazuara në kushtet e tregut në datën e bilancit kontabel. Teknika të tjera, si p.sh parashikimi i flukseve monetare të skontuara përdoren për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të mbetura. Vlera e mbartur minus provizionet për rënie në vlerë të “të drejtave për t’u arkëtuar dhe detyrimeve për t’u paguar” supozohet që janë pouthuajse të njëjta me vlerën e tyre të drejtë. Vlera e drejtë e detyrimeve financiare për qëllime të shënimeve shpjeguese vlerësohet duke skontuar fluksin e ardhshëm të kontraktuar të parave me normën aktuale të interesit të tregut e cila është e vlefshme për instrumenta të ngjashme financiare. Ne fund te periudhes ushtrimore 2013 vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare eshte e perafert me vleren e tyre te mbetur.

Periudha qe u mbyll me 31 dhjetor 2013

	Kredi dhe Paradheniet	Te tjera me kosto te amortizueshme	Total
Aktivët Afatshkurter	54,912,247	600,599,234	655,511,481
Aktivët Afatgjata	0	0	0
Total	54,912,247	600,599,234	655,511,481
Detyrimet Afatshkurter	1,229,263,282	0	1,229,263,282
Detyrimet Afatgjate	2,115,874,077	0	2,115,874,077
Kapitali	0	0	0
Total	3,345,137,359	0	3,345,137,359
Diferenca ne fund te periudhes ,	(3,290,225,112)	600,599,234	(2,689,625,878)

Periudha qe u mbyll me 31 dhjetor 2012

	Kredi dhe Paradheniet	Te tjera me kosto te amortizueshme	Total
Aktivët Afatshkurter	18,359,315	2,605,959,167	2,624,318,482
Aktivët Afatgjata	0	0	0
Total	18,359,315	2,605,959,167	2,624,318,482
Detyrimet Afatshkurter	590,617,824	0	590,617,824
Detyrimet Afatgjate	3,170,702,516	0	3,204,146,357
Kapitali	0	0	0
Total	3,761,320,340	0	3,794,764,181
Diferenca ne fund te periudhes ,	(3,742,961,025)	2,605,959,167	(1,170,445,699)

5. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit

Kompania kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Çmuarjet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet që janë të arësyeshme sipas rrethanave.

5.1 Monedha Funksionale dhe raportuese

Monedha funksionale e Kompanisë është LEK. Vendosja e LEK si monedhe funksionale të Kompanisë kërkon gjykime të rëndësishme. Në marrjen e këtij gjykimi, merrra në konsideratë monedhën e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin operon. Kompania gjithashtu merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm në përcaktimin e monedhës funksionale:

- a) monedha që influencë kryesisht çmimin e shitjes për të mirat dhe shërbimet (jo është monedha në të cilën çmimet e shitjes se të mirave dhe shërbimeve të saj janë përcaktuar), dhe ku faktorë ekonomikë përcaktojnë çmimet e shitjes se të mirave dhe shërbimeve.
- b) monedhat që influencojnë kryesisht fuqinë puntore, materialet, dhe kosto të tjera të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve (kjo është monedha me të cilën kosto të tilla janë përcaktuar)

5.2 Njohja e te Ardhurave

(i) Ardhurat nga shitja e produkteve të rregulluar

Njohja e te ardhurave për klientët të cilët janë objekt i shërbimeve përfshin një vlerësim të vlerës së ujit të konsumuar dhe të tjera shërbime të lidhura midis datës së fundit të matjes dhe datës së fundit të periudhës ushtrimore. Në datën e bilancit kjo shumë është për tu faturuar në datën tjetër të matjes. Drejtimi mendon që përlogaritja e konsumit për periudhën afërsisht 15 ditore për klientët paraqet besueshëm vëllimin e te ardhurave që realizohen gjatë kësaj periudhe. Megjithatë ndryshimi në këto supozime nuk do të ketë efekte materiale në raportimin e te ardhurave.

(ii) Grantet

Një numër i caktuar grantesh janë përfshirë në librat, të përfituara nga transaksione të ndryshme me donator të ndryshme. Drejtimi analizoi destinacionin dhe dokumentacionin e këtyre granteve. Një shumë e caktuar grantesh kanë qenë dhuruara si kontribut në materiale dhe aktive. Grantet njihen si të ardhura për pjesën e amortizimit të aktiveve për të cilat janë përfituar.

4. Çmuarje dhe gjykime ne kontabilitet (vijon)

5.3 Renia ne vlere e aktiveve

a. Aktivet fikse

Kompania testoi Aktivet Fikse te saj nese ato kane renie ne vlere ne perputhje me politikat kontabel. Si rrejdhoje e kesaj politike ne aktivet fikse jane testuar per vleren e tyre ne vitin 2012 dhe efekti prej Lek 409 Milion i shteses se vleres se ketyre aktiveve eshte njohur ne llogarite perkatese te kapitalit, bazuar ne vendimin 5 date 31/05/2009 te KM per autorizimin e UKD per rivleresimin e aktiveve afatgjata materiale dhe rekomandimit te Grupit te Auditimit te Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit Nr Prot 824/4 date 5/5/2010 dhe Kerkeses se paprotokolluar te UKD per realizimin e Rivleresimiti nga UKD dhe perpiluar efektet e rivleresimit te Aktiveve te UKD.

Shoqeria vleresoi se masa e Rivleresimit te Aktivit Rrjete Kanalizime nuk qendron si rrejdhoje e mos aplikimit te njetrajtshmerise se aplikimit te SKK 5: Modeli i Rivleresimit, si pasoje ka rrimarre ne celje te vitit 2013 shumen Lek 126 Milion Lek ne Fitim Humbje te Mbartur duke rritur vleren e aktivit dhe amortizimit perkates.

Ne vijim drejtimi ka gjykuar qe vlera neto kontabel e aktiveve fikse eshte aftersisht e njejte me vleren e rikuperueshme. Si rrjedhoje nuk ka efekte te humbjes/ rritjes se vleres se aktiveve per periudhen ushtrimore qe u mbyll me 31 dhjetor 2013.

b Inventaret

Inventaret jane matur me me te voglen midis kostos dhe vleres se realizueshme. Vlera neto e realizueshme eshte cmimi i parashikuar i shitjes ne nje kurse normal biznesi, minus kostot e vleresuara te perfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Inventari dhe prodhimi në proces vlerësohen me më të voglën midis kostos (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti) dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.

Per nje pjese te caktuar e inventareve UKD kishte parashikuara qe nuk do te realizonte te ardhura nga shitja ne fund te 31 Dhjetor 2013, si pasoj Drejtimi gjykoi qe keta inventare do te zhvleresohen me qellim paraqitjen e efekteve te sa me siper.

Nje paraqitje e efekteve ne fitim apo humbje te ketij veprimi eshte dhene ketu:

	Periudha qe u mbyll me	
	31-dhjet-2013	31-dhjet-2012
Gjendja Ne fillim te peridhes	0	0
Provizione per Renien ne Vlere te Inventarve	90,856,428	0
Rimarrje e Renies ne Vlere		
Gjendja Ne fund te peridhes	90,856,428	0

5.Çmuarje dhe gjykime ne kontabilitet (vijon)

5.4 Renia ne Vlere e Llogarive te arkëtueshme

Kompania testoi Llogarite e Arketushme te saj nese ato kane nje renie ne vlere ne perputhje me politiken kontabel te pershkruara ne Shen. 3.9 pg. 3) . Ndryshe nga testi i renes ne vlere ne 2012 Drejtimi i UKD beson qe identifikimi i llogarive te arketueshme bazuar politiken kontabel Shen 3.9 pg. 1) eshte me korrekt. Prandaj nje korrektim i metodologjise se renies ne vlere e shoqeruar nga ky ndryshim rezultoi ne nje shume te renies ne vlere ne 2013 ishte 196 Milion Lek.

Levizjet e humbjes se vleres paraqiten ne vijim:

	2013	2012	2011
Gjendja ne Fillim	876,926,031	738,616,764	0
<i>Shtesa (Humbje Vleres)</i>	<i>196,041,461</i>	<i>138,309,267</i>	<i>738,616,764</i>
Konsumatore familjare	181,088,958	115,633,403	611,506,406
Subjekte private	601,150	6,848,809	45,955,878
Ente buxhetore	14,351,353	15,827,055	81,154,480
<i>Pakesime/Perdorimi (Humbje Vleres)</i>			
Gjendja Ne Fund	1,072,967,492	876,926,031	0

5.4.2 Metoda e Vleresimit

Bazuar ne politiken kontabel pg. 3.9.2 UKD evidenton llogarite e arketueshme per efekte te vleresimit te vleres se drejte si vijon:

Vleresuar Individualisht

UKD fillimisht vlereson nese ka evidence te humbjes se vleres ne rang individual dhe qe kjo evidence eshte e rendesishme ne grupin e aktivitetit financiar.

Nese UKD identifikon sa me siper qe nuk ka evidence per humbje vlere atehere ajo e perfshin aktivin ne nje klase te aktiveve financiare me karakteristika te ngjashme te riskut te kreditit dhe i vlereson ata kolektivisht per renien ne vlere. Aktivet qe jane vleresuar individualisht per renien ne vlere dhe per te cilet humbja nga renia ne vlere eshte ose vazhdon te njihet nuk jane perfshire ne nje vleresim kolektiv per renien ne vlere.

Vleresuar Kolektivisht

Flukset e ardhshme monetare ne nje grup te aktiveve financiare qe jane vleresuar kolektivisht per renien ne vlere parashikohen ne baze te eksperiencës se humbjes historike per aktivet me karakteristika te ngjashme te riskut te kreditit me ato ne grup.

Ne rastet kur UKD SH.A. nuk ka nje eksperience humbjeje specifike ose ka nje eksperience te pamjaftueshme, atehere perdor eksperiencën e shoqerive qe operojne ne te njejtin treg.

Humbjet jane rregulluar ne baze te te dhenave aktuale te vezhguara per te reflektuar efektet e kushteve aktuale te cilat nuk kane ndikuar periudhen ne te cilen eshte bazuar eksperiencia e humbjes historike dhe te menjanoje efektet e kushteve ne periudhen historike qe nuk ekzistojne aktualisht.

Vleresimet e ndryshimeve ne flukset e ardhshme monetare te parashikuara reflektojne dhe jane lidhur ne menyre konsistente me ndryshimet e te dhenave te lidhura nga periudha ne periudhe (te tilla si normat e papunesise, cmimet e prones, cmimet e produkteve, fuqia paguese ose faktore te tjere qe jane tregues te humbjeve te shkaktuara ne grup dhe magnitudes se tyre).

Metodologjia dhe supozimet e perdorura per flukset e ardhshme te parashikuara jane rishikuar rregullisht per te zvogeluar ndonje diference midis humbjes se parashikuar dhe eksperiencës se humbjes aktuale.

5.Çmuarje dhe gjykime ne kontabilitet (vijon)

5.4.3 Vleresimi i Llogarive e Arketueshme

a. Llogarite e Arketueshme te testuara Kolektivisht

UKD sha ka vleresuar eksperiencen e humbjes historike per aktivet me karakteristika te ngjashme te riskut te kreditit me ato ne grup.

Si e tille ajo ka marre ne konsiderate keta faktore

- Zona e sherbimit : duke percaktuar zonat vijuese te cilat kane karakteristika te ngjashme
 - o Durres – qyteti i Durresit
 - o Zona Plazh
 - o Bashkia Shijak
 - o Bashkia Manez
 - o Bashkia Sukth
 - o Zona Fshat
- Kategoria e Klientit : nje tregues qe percakton tarifimin per konsumet e faturuara dhe qe jane te percaktuar ne kuadrin rregullator te uji :
 - o Familjar
 - o Privat
 - o Ente Shtetetore
- Menyra e faturimit : menyra e faturimit nga UKD percakton sjelljen e konsumatorit e cila eshte adverse kundrejt nje metode apo tjetre. Ne pergjithesi supozohet qe faturimi afrofe con ne adversitetin e konsumatorit kundrejt pagimit te faturave. Si e tille Ukd ka specifikuar keto menyra :
 - o Me matje
 - o Afrofe- e cila zbatohet kundrej aplikimit te konceptit te banore per lidhje une shumezuar me konusmin mesatar per banor ne dite e cila arrin 150l/c/d ose 4m3/c/m
 - o Kliente me tarife sherbimit – te cilet kane kane pezulluar perkohosisht kontratat e sherbimit si pasoje e mospranise fizike ne prone
- Lloji Sherbimiti qe ofrohet eshte nej indikator tjetër i cili con ne rritjen e vleres absolute te fatures dhe aversistetti te konsumatorit kur krahason vlerat e fatures me fqinj apo te njohur
 - o Vetem uje
 - o Uje dhe kanalizime

Sa me siper u evidentuar : Faturimit Vjetor , Arketimi i fatures Korrente Vjetor , Shuma e Te drejtes ndaj Klienteve.

5.Çmuarje dhe gjykime ne kontabilitet (vijon)

Raportet mesatare per kategori klietnesh te perdorura per vleresimin e humbjes vijojne:

AM/JO	Kategoria	Masa e Humbjes
JO	Familje	16%
	Institucion	15%
	Kompani private	20%
JO Total		17%
PO	Familje	76%
	Institucion	32%
	Kompani private	64%
PO Total		76%
TOTALI		34%

5.5 Fshirja e Llogarive te arkëtueshme si rezultat i Aministise

Ne 21 Prill 2013, ne baze te nenit 30 pghr 1 & 2, 3–“Falja e detyrimeve te detyrimeve te faturave te papaguara te konsumit te ujit per konsumatoret familjar” i Ligji 10418 dt 21.4. 2013 “ Per legalizimin e kapitalit dhe faljen e nje pjese te borxhit doganor dhe Tatimor” u aministuan te gjitha llogarive te arkëtueshme te UKD gjendje ne pozicionin financiar qe i referohen situates te llogarive te arkëtueshme me te faturuara deri me 31 dhjetor 2007. Nje pernmbledhje e kesaj situates me daten e hyrjes ne fuqi te ligjit paraqitet:

Gjendjet e llogarive ne pozicionin financiar te UKD sha do te paraqiten si ne vijim:

	2011	Nuk Kane perftuar nga Amnistia	Kane perftuar nga Amnistia
Konsumatore familjare	823,193,024	166,089,438	657,103,586
Subjekte private	89,431,057	86,443,352	2,987,706
Ente buxhetore	128,091,015	50,361,128	77,729,887
Te tjera			
Totali	1,040,715,097	302,893,918	737,821,179
<i>Provizioni</i>	<i>(738,616,764)</i>	<i>(103,708,742)</i>	<i>(634,908,022)</i>
LLA NETO	302,098,333	199,185,176	102,913,157

	2012	Nuk Kane perftuar nga Amnistia	Kane perftuar nga Amnistia
Konsumatore familjare	989,592,608	231,119,792	758,472,816
Subjekte private	101,382,016	97,401,990	3,980,026
Ente buxhetore	158,868,354	68,141,144	90,727,211
Te tjera			
Totali	1,249,842,978	396,662,925	853,180,053
<i>Provizioni</i>	<i>(876,926,031)</i>	<i>(135,053,372)</i>	<i>(741,872,659)</i>
LLA NETO	372,916,947	261,609,553	111,307,393

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2013 se bashku me shenimet shoqeruese
Shumat ne mije Leke (perndryshe shkruhet)

5.Çmuarje dhe gjykime ne kontabilitet (vijon)

	2013	Nuk Kane perftuar nga Amnistia	Kane perftuar nga Amnistia
Konsumatore familjare	1,284,926,213	340,753,308	944,172,905
Subjekte private	103,114,636	97,908,271	5,206,365
Ente buxhetore	184,785,150	83,758,411	101,026,739
Te tjera			
Totali	1,572,825,999	522,419,989	1,050,406,010
<i>Provigjoni</i>	<i>(1,072,967,492)</i>	<i>(174,237,804)</i>	<i>(898,729,688)</i>
Humbja e vleres nga Fshirja e LLA	499,858,507	348,182,185	151,676,322

Nderkaq qe efektet ne ardhura dhe shpenzime vijojne:

	2013	2012	2011
Gjendja ne Fillim	876,926,031	738,616,764	0
<i>Shtesa (Humbje Vleres)</i>	<i>196,041,461</i>	<i>138,309,267</i>	<i>738,616,764</i>
